Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Burim Guri	**11.01.2024**	**15.01.2024**	**2024/0037**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 09.01.2024, OE "NIKA PrO- Ing" SH.P.K.- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2024/0037, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "LURN" sh.p.k. - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Demontimi, zhvendosja, lidhja instalimi dhe konfigurimi i gjeneratoreve ne ndertesat e Qeverise dhe IRK", me nr. të prokurimit: "214-23-11743-2-3-6", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontrates: sherbim, vlera e parashikuar e kontrates: 9,616.50 €. Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP -së, më Nr. 2024/0037 i dt:09.01.2024. Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 i LPP-se, Neni 6 i LPP-se, Neni 7 i LPP-se, Neni 59 i LPP-se, Neni 60 i LPP-se, Neni 69 i LPP-se, Neni 72 i LPP-se.

Te nderuar ne me dt.22.12.2023 permes platformes elektronike e-prokurimi jemi njoftuar se ju si AK keni rekomanduar OE Lurn Shpk oferte me e shtrejt se oferta jone per ekte projekt: Dhe na kan eliminuar kinse nuk kemi kontrate te natyes se ngjashme te puneve.

Pretendimi 1. Pretendimet e AK-se per eliminimin tone nuk qendrojne pasi ne kemi ofruar nje kontrate te ndertimit - Ndertimi i Qendres Familjare ne Gjilan me OJQ Chatar Charity nuk eshte e natyres se njejte NUK qendron sepse kompania jone ka kryer me sukses kontraten e ngjajshme dhe te natyres se njejte ku kemi kryer pun& elektrike te gjithe objektit me tenderin ne fjale duke filluar prej instalimeve te energjise elektrike dhe pune te tjera elektrike.

Pretendimi 2. Ne si OE i plotesojm kushtet per te fituare kete tender pasi jemi oferta me e lire me cmim. Duke u bazuar ne to gjitha deshmite dhe faktet qe u ceken me larte konstatojme se ekzaminimi, vleresimi dhe krahasimi i tendereve nuk eshte bere ne harmoni me nenin 59 te LPP-se, sepse eshte rekomanduar per kontrate OE i cili ka gene me cmim me te larte.

Gjithashtu ju nuk e keni respektuar edhe nenin 7 te LPP-se, duke na diskriminuar neve si operator ekonomik, edhe pse i kemi plotesuar te gjitha kerkesat e FTD-se dhe te njoftimit per kontrate, nuk jemi shpallur fitues te ketij tenderi por po shihet se qellimi AK-se eshte qe ne mos te shpallemi fitues te ketij tenderi. Paragrafi 1 i nenit 7 te LPP-se e parasheh garte qe "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operator& ekonomik ne menyre te barabarte dhe jo- diskriminuese dhe do te veproje ne menyre transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 te LPP-se e parasheh qe Gjate udhehegjes se aktiviteteve to prokurimit, to gjitha autoritetet kontraktuese do to sigurojne; qe (vi) qe tenderi i zgjedhur to perputhet me to gjitha aspektet permbajtjesore to kushteve, kritereve dhe specifikimeve perkatese, mirepo ju nuk i jeni permbajtur as kesaj dispozite ligjore. Po ashtu ju nuk e keni respektuar edhe nenin 6 to LPP-se edhe pse autoritetet kontraktuese jane to obliguar qe to sigurojne qe fondet publike dhe burimet publike to perdoren ne menyren me ekonomike, njekohesisht duke marre ne konsiderate qellimin dhe lenden e prokurimit ashtu sic parashihet ne nenin 6 to LPP-se.

Autoriteti kontraktues duhet to kete ne konsiderate edhe nenin 1 to LPP-se, pasi qe dihet se gellimi i ketij ligji eshte to siguroje menyren me efikase, me transparente dhe me to drejte to shfrytezimit to fondeve publike, burimeve publike si dhe to gjitha fondeve dhe burimeve to tjera to autoriteteve kontraktuese ne Kosove.

Deshmia e puneve to kreyera:

1	Furnizimi I RACK minimal per montim ne mur ne korridor qe permban Patch Panel 2 cope dhe switch 12 port	cope	1.00	115.00	115.00	
2	Furnizimi dhe montomi I kabllos UTP per internet , telefon dhe interfon	m	30500	0.70	213.50	

3	Furnizimi dhe montimi I prizave te internetit	cope	20.00	5.50	110.00	
4	Furnizimi dhe montimi I prizave te TV	cope	3.00	4.30	12.90.	
5	Furnizimi dhe montimi I kabllos HDMI nga kompjuterideri te TV me gjatesi 15m	cope	2 00	18_00	36.00	
6	Furnizimi dhe montimi I kabllit kaoksial RGG per TV	m	10000	0.60	60.00	
7	Furnizimi dhe montimi I centrales se alarmit te *zjarrit,* tip joadresibile	cope	1 00	250.00	250.00	
8	Furnizimi dhe montimi I detektorit te tymit ose temperatures (sipas projektit) te alarmit te zjarrit Jo adresibil komplet perfshire edhe bazen	cope	19 00	24.00	456.00	
9	Furnizimi dhe montimi I detektorit manual (buton me xham te thyeshem) te alarmit te zjarrit Jo adresibil komplet perfshire edhe bazen	cope	2.00	24.00	48.00	

10	Furnizimi dhe montimi I sirenave te airmit te zjarrit te brendshme	cope	1.00	23.00	23.00	
11	Furnizimi dhe montimi I sirenave te airmit te zjarrit i jashtem	cope	1.00	30.00	30.00	
12	Furnizimi dhe montimi I kabllit te alarmit te zjarrit. 2x0 75. me ngjyre te kuqe. adekuat per alarm te zjarrit	m	150.00	0.50	75 00	
13	Furnizimi dhe montimi I rrjetit CCTV ku perfshine kabllimin, NVR bashk me monitorin, kamera te brenshme 2 cope dhe kamera te jashtme 4 cope Ne pozicion te perfshihet komplet pune e CCTV sipas vizatimit E-03 te perdheses	cope	1.00	900.00	900.00	
14	Material I imet I paparapare	paushall	1.00	30.00	30.00	
IV	Rrymat e dobeta					**2,359.40**

V	**TOKEZIMI DHE RRUFEPRITESI**					
1 2 3 4	Furnizimi dhe montimi I shiritit FeZn 25x4mm ne themelet e objektit	m	100 00	2 80	280.00	
2	Furnizimi dhe montimi I sondave per pertokzim	cope	4.00	10.00	40 00	
3	Shtrirja e shiritit(trakes) te tokezimit Fe-Zn 20x3mm nqa themelet deri ne Iartesin e kulmit	m	20 00	2.50	50.00	
4	Furnizimi dhe montimi I shiritit FeZn 20x3mm ne **hanirpn** *P kIIMP1IP*	m	100 00	2 50	250 00	

Ndriquesit dhe shpenzuesit e tjere

		Njesia	sasia	cmimi	Vlera
1	Furnizimi dhe montimi I trupit ndriques te tipit plafornjek . LED 18W per vendosje ne banjo dhe hyrje.	cope	17.00	15	255.00
2	Furnizimi dhe monitorimi I kabllit PPY 3X1.5MM per trupin ndriques te tipit Plafonjerk ne e banjo me gjatesi mesatare 6m. Paguhet per njesi.	cope	17.00	7	119.00

3	Furnizimi dhe montimi I trupit ndriques LED PANEL me dimenzione 60x60cm. 32 W per vendosje ne zyre. 15m	cope	48.00	25	1.200.00
4	Furnizimi dhe montimi I kabllit PPY 3x1.5mm per trupin ndriques LED PANEL me gjatesi mesatare 5m. Paguhet per njesi	cope	48.00	7	336.00
5	Furnizimi dhe montimi I trupit ndriques emergjent LED max 10W me bateri me autonomi 1 h pas nderprejes se rrymes.	cope	14.00	24	336.00
6	Furnizimi dhe montimi I kabllit PPY 3x1.5mm per trupin ndriques emergjent me gjatesi mesatare 8m. Paguhet per njesi	cope	14.00	7	98.00
7	Furnizimi dhe montimi I nderpresit te thjesht (njefish) per ndriqim. Nderpreresi te jete e tipit modulare	cope	25.00	7	175.00
8	Furnizimi dhe montimi I senzorit te levizjes per ndriqim per montim ne tualete	cope	5.00	15	75.00
9	Furnizimi dhe montimi I kabllit PPY 3x1.5 per nderpreres me gjatesi mesatare 8m	cope	25.00	7	175.00
10	Furnizimi dhe montimi I prizave monofazore te njefishta 220V 16.A. Priza te jete e tipit modulare	cope	38.00	7	266.00
11	Furnizimi dhe montimi I prizave monofazore te dyfishta 220V 16.A. Priza te jete e tipit modulare	cope	4.00	10	40.00
12	Furnizimi dhe montimi I setit modulare 7 modulesh per montim ne mure ku perfshihen tri prize nejfazore dhe hapsirea per prize te internetit dhe telefonit	cope	7.00	20	140.00

13	Furnizimi dhe montimi I setit modulare 8 modulesh per montim ne dysheme ku perfshihen 4 priza njefazore dhe hapsira per prize te internetit dhe telefonit	cope	5.00	88	440.00

Perfundimi:

Pretendimi 1. Ne kemi kryer pune te ngjashme.

Pretendimi 2. Oferta jone eshte me e lirese oferta e shpallur fitues. Ne fund kerkojme nga OSHP qe te nxjerrni:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE Nika Proing sh.p.k. Demontimi, zhvendosja, lidhja instalimi dhe konfigurimi i gjenerateve ne ndertesat e Qeverise dhe IRK.

ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-se per dhe lenda kthehet ne **RIVLERESIM** dhe gjate rivleresimit, ekzaminimi, vleresimi dhe krahasimi i ofertave te behet ne harmoni me kerkesat e dosjes se tenderit, njoftimit per kontrate dhe konform dispozitave te LPP-se. Nese nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi te detyruar te vazhdojme proceduren ligjore ne instutucionet tjera kompetente.

KRITERET PËR VLERËSIM

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

a. Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Nenin 65 të Ligjit Nr. 04 L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L068 dhe ligjin Nr. 05 L-092.

b. Një dokument nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku në tremujorin e fundit para datës së publikimit të Njoftimit për kontratë.

c. Një dokument i lëshuar nga Gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit, që vërteton se tenderuesi i përmbush "Kërkesat e pranueshmërisë", i cili dokument duhet të jetë jo me i vjetër se 3 muaj para datës së publikimit të Njoftimit për kontratë.

d. Një dokument i lëshuar nga Gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit, që vërteton se tenderuesi i përmbush "Kërkesat e pranueshmërisë", se drejtuesit, menaxheret e saj gjatë dhjetë viteve të kaluara nuk janë shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale ose civile, i cili dokument duhet të jetë jo me i vjetër se 3 muaj para datës së publikimit të Njoftimit për kontratë.

Dështmia e kërkuar dokumentare:

a. Një deklaratë e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar ne dosjen e tenderit,Aneksi 2 (Origjinal).

b. Vërtetimin nga Administrata Tatimore (kopje), duhet të dorëzohen vetëm ngatenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës. Dështimi në dorëzim të Vërtetimit nga administrata tatimore, tenderi i tij do të refuzohet dhe AK do të vazhdoj me tenderuesin e listuar në vendin e dytë, si dhe do te konfiskohet sigurimi i tenderit nëse e njëjta është kërkuar.

c. Çertifikatë nga Gjykata ThemeloreDepartamenti për Çështje Ekonomike apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të operatorit ekonomik (kërkohet origjinal ose i vërtetuar noterizuar nga institucioni kompetent në vendin tuaj të themelimit), duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës. Dështimi në dorëzim të Çërtifikatës nga Gjykata perkatëse, tenderi i tij do të refuzohet si dhe do te konfiskohet sigurimi i tenderit nëse e njëjta është kërkuar, AK do të inicioj procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-se dhe te vazhdoj me shpërblim te kontratës me Tenderuesin qe është listuar në vendin e dytë.

d. Çertifikatë nga Gjykata kompetente- (kërkohet origjinal ose i vërtetuar noterizuar nga institucioni kompetent në vendin tuaj të themelimit), duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës. Dështimi në dorëzim të Çërtifikatës nga Gjykata perkatëse, tenderi i tij do të refuzohet si dhe do te konfiskohet sigurimi i tenderit nëse e njëjta është kërkuar, AK do të inicioj procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-se dhe te vazhdoj me shpërblim te kontratës me Tenderuesin qe është listuar në vendin e dytë.

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

Certifikatë e regjistrimit të biznesit, regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe ose të korporatës në vendin tuaj të themelimit me Informata mbi biznesin dhe veprimtaritë. Për Operatorin Ekonomik jo rezident ne Kosove, nëse shpërblehet me kontratë, para nënshkrimit te kontratës, është i obliguar qe ta regjistrojnë përfaqësinë e biznesit ne Republikën e Kosovës.

b. Deklarues i TVSH-së, (për kompanitë vendore).

Dështmia e kërkuar dokumentare:

a. Certifikatë e regjistrimit të biznesit, me informata dhe veprimtaritë e biznesit (kopje). b. Certifikata e TVSH-së (kopje).

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.Operatoret ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë se paku një kontratë të ngjajshme, të realizuar në tri vjetët e shkuara, para datës së publikimit të këtij njoftimi për kontratë.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

2. Lista e projekteve të realizuara e nënshkruar dhe vulosur nga OE për projektet e realizuara në lëmin e kerkuar (nga Njoftim përKontratë për periudhën e shkuar trevjeçare), duke bashkëngjitur referenc ose procesverbalet e pranimit përfundimtar të projekteve.

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Komisioni i vlerësimit në bazë examinimit, vlerësimit dhe krahasimin të ofertave, ka konstatuar se për këtë tender, "Demontimi, zhvendosja, lidhja instalimi dhe konfigurimi i gjeneratorëve ne ndërtesat e Qeverisë dhe IRK", janë pranuar 2 tenderë-oferta.dhe ne baze te dokumentacionit te prezantuar në tenderët e tyre, një(1) tenderues (LURN SH.P.K., Rr Ibrahim Krasniqi nr.10, 10000, Prishtine) është i përgjegjshëm, pasi që i plotësonë:

- Kërkesat formale/administrative
- Kërkesat e pranueshmërisë dhe përshtatshmërisë profesionale;
- Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare,
- Kërkesat teknike dhe/apo aftësitë profesionale dhe

o Përputhshmëria teknike me specifikimet dhe kërkesat e dhëna në specifikimin teknik të dosjes së Tenderit,

kurse një (1) tenderues (NIKA PrO- Ing SH.P.K., Rr.Rexhep Bislimi, 70000, Ferizaj) është i papërgjegjshëm.

Duke e marrë parasysh se kriter vlerësimi ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët, komisioni vlerësues u përcaktua që të pranohet oferta e " S(LURN SH.P.K., Rr Ibrahim Krasniqi nr.10, 10000, Prishtine ofruar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët në shumë prej: 9,508.00 Euro dhe ne si komision i vlerësimit i propozojmë zyrtarit përgjegjës të Prokurimit ta shpërblej me kontratë.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **NIKA PrO- Ing SH.P.K.**

Sqarim fillestar lidhur me aktivitetin e prokurimit: "**Demontimi, zhvendosja, lidhja instalimi dhe konfigurimi i gjeneratorëve ne ndërtesat e Qeverisë dhe IRK",** me numër të prokurimit: **214-23-11743-2-3-6,** të iniciuar nga **AK – MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME.**

Pretendimi ankimor ka te beje me arsyetimin e eliminimit te OE ankues, ku Autoriteti Kontraktues, përmes letrës standarde ka eliminuar OE "Nika Pro-Ing" sh.p.k., ku ka përcaktuar qe nuk është prezantuar dëshmi lidhur me kërkesën e përcaktuar ne piken III.4, te FTD-se, ku AK - MPB ka kërkuar:

Kapaciteti teknik dhe ofesional: 2. Operatoret ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë se paku një kontratë të ngjajshme, të realizuar në tri vjetët e shkuara, para datës së publikimit të këtij njoftimi për kontratë.

Dëshmia e kërkuar dokumentare: 2. Lista e projekteve të realizuara e nënshkruar dhe

vulosur nga OE për projektet e realizuara në lëmin e kërkuar (nga Njoftim për Kontratë për periudhën e shkuar trevjeçare), duke bashkëngjitur referencë ose procesverbalet e pranimit përfundimtar të projekteve.

OE ankues ne oferte ka prezantuar kontratën te lidhur me një OJQ "QATAR CHARITY", ne prani te noterit me titull: "NDERTIMI E OBJEKTIT TE QENDRES SE MJEKSISE FAMILJARE".

Eksperti shqyrtues sqaron se lende e kesaj procedure te prokurimit ka te beje me demontim, zhvendosje, instalim dhe konfigurim te gjeratoreve ne ndërtesat e Qeverise dhe Institucioneve të Republikës se Kosovës.

Kontrata e lidhur me QATAR, nuk ka te beje me këtë procedure te prokurimit megjithë atë OE ankues bashkangjitur ne ankese ka prezantuar një paramase – parallogari ku disa nga pozicionet e përshkruara ne ta te ndërlidhur me procedurën e prokurimit.

Bazuar ne dëshminë e bashkangjitur ne ankese-paramasen, eksperti shqyrtues propozon qe ky aktivitet i prokurimit te kthehet ne rivlerësim me qellim qe Autoriteti Kontraktues konform nenit 59 dhe 72 te LPP-se te kërkojë sqarim nga kontraktuesi QATAR, me qe OE ankues pretendon se e njëjta paramase është realizuar me sukses nga i njëjti kontraktues ne mënyrë qe AK, te vërtetoj nëse paramasa e njëjtë përkatësisht pozicionet e përshkruara ne te janë realizuar nga OE ankues.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **NIKA PrO- Ing SH.P.K.**

Burim Guri

REPUBLIKA E KOSOVËS
PANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
PRISHTINË/A
REPUBLIKA KOSOVA